



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:182577

Datë: 18.05.2023

Numri i dokumentit: 04294228

PS.nr.11/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI SPECIAL, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, Lutfi Shala dhe Kujtim Krasniqi anëtar të trupit gjykues dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh H i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.87/2021 e datës 11.03.2023, për shkak të veprave penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 281 par.1 nën par 1.1 të KPRK-së të kryer në vazhdimësi nga neni 81 të KPRK-së dhe veprën penale Kontrabandimi me migrant nga neni 170 par 1 lidhur me par.6 të KPRK-së në vazhdimësi lidhur me nenin 81 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit të fundit kryesor të dt.04.05.2023 në të cilën të ishin të pranishëm prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës – Merita Bina Rugova, i pandehuri Sh H me mbrojtësit av.Sylë Hoxha dhe av.Haxhi Millaku të dy sipas autorizimit, me datë 05.05.2023 mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

Sh H, me nofkën “..”, nga i ati ..., dhe e nëna ..., e gjinisë ..., i lindur me dt.... në fshatin Zhur - Komuna Prizren, ku edhe jeton, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Sllovenisë, me numër personal të RKS-së, dhe nr. personal të Sllovenisë ..., me profesion mekanik, ka të kryer

shkollën fillore, në procedurë të shkurorëzimit, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, gjendet në paraburgim nga data 19.08.2021;

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Si anëtar i grupit kriminal me të gjykuarit V H, A D, A L, Ma C dhe B I të cilët janë dënuar në Slloveni për vepra të njëjta penale, si dhe me E Sh dhe F H të cilët kanë qenë në arrati, pa autorizim ka ble, ka ofruar për shitje, ka transportuar, ka poseduar me qëllim të shitjes, ka shp[rndar] dhe ka shitur sasi të mëdha të substancave të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë – kokainë dhe heroinë, në atë mënyrë që;

1. Me dt. 15. Mars 2016 pas bisedës telefonike të pandehurit Sh H me agjentin e fshehtë të policisë Sllovene i cili ka qenë duke zbatuar masën e fshehtë hetimore të blerjes së simuluar, i pandehuri Sh, me V H është takuar me dy agjentët të fshehtë rreth 12 ;00 h në garazhin e qendrës tregtare Tush, në Koper, Ankaranska Cesta nr. 2, me q`rast, të njëjtëve iu kanë ofruar për shitje sasi të mëdha të drogës, ndërsa i pandehuri Sh e ka nxjerrë nga xhepi i djathtë i pantallonave një pako të vogël alumini me 0.40 gr të drogës së llojit kokainë si mostër, të cilën ia ka dorëzuar agjentit me nr. 1122;
2. Me dt.14 Prill 2016 rreth 17;30 h me V H, pas bisedës telefonike me dy agjentët të fshehtë të policisë, të cekur më lart, është takuar me të njëjtit në parkingun tek ish Kantieri i anieve në Izola, Cankarjev drevored nr. 23, ku të njëjtëve iu kanë ofruar shitjen e sasive të mëdha të drogës, e pastaj i pandehuri Sh është larguar me veturë, ndërsa të gjithë të tjerët kanë mbetur në parking dhe pas pak ka ardhë përsëri dhe agjentëve iu ka shpërndarë drogën e llojit heroinë në atë mënyrë që iu ka thënë qe ta hapin veturën e tyre, është ulur në të njëjtën dhe ne sirtar të veturës i ka futur dy pako të vogla alumini me 1,04 g dhe 1,01g të drogës së llojit të njëjtë, të lartcekur, por me cilësi të ndryshme si mostra;
3. Me dt. 10. Maj 2016 së bashku me V H, F H dhe personin të paidentifikuar me emrin Doni, në vendin të quajtur Lucia, Komuna Piran, nga personi i paidentifikuar me nofkën "Shqiptari", me qëllim të shitjes së mëtutjeshme e ka blerë sasi të pavërtetuar të drogës

së ndaluar të kokainës, ashtu që blerjen e ka organizuar V H, ndërsa i pandehuri Sh dhe F H e kanë kryer pagesën;

4. Me dt. 11. Maj 2016 rreth orës 17 h, pas bisedës telefonike të të pandehurit Sh H me agjentin e fshehtë, i pandehuri Sh, me V H e A D është takuar me dy agjentët të fshehtë, në parkingun tek ish Kantieri i anieve, ku kanë arritur marrëveshje që t'iu shesin 500 gr heroinës për shumën prej 7.500 €, ashtu që i pandehuri Shqipron iu ka dorëzuar narkotikun, në atë mënyrë që e ka marrë veturën e agjentëve dhe me të njëjtën ka shkuar në Gregorqieva ulica nr. 49 në Izola, ku në sirtar, në pjesën e përparme të veturës e ka futur një pako prej 403,79 gr të heroinës, të ngjeshur në formë katrore, e pastaj e ka sjell veturën në vendin e takimit dhe përsëri iu ka dorëzuar agjentëve të fshehtë;
4. Gjatë takimit të cekur më lart, në vendin dhe kohën e lartcekur, me dt. 11. Maj 2016 me V H, dy agjentëve të fshehtë të lartcekur të policisë ua kanë ofruar në shitje narkotikë të llojeve të ndryshme në sasi të mëdha, duke pohuar se janë të cilësisë së lartë ashtu që edhe kërkesa është e madhe dhe duhet ta porosisin një muaj përpara, ndërsa çmimi është 15 mijë për kilogram të heroinës dhe 3 mijë për kilogram të kokainës dhe amfetaminës;
5. Pas bisedave telefonike të pandehurit Sh H me agjentët të fshehtë, me dt. 3. Qershor 2016 rreth 12 h është takuar me të njëjtit në parkingun tek ish Kantieri i anieve Izola, në adresën Cankarjev drevored 23 në Izola, ku i pandehuri përsëri iu ka ofruar shitjen e llojeve të ndryshme të narkotikëve ashtu që të njëjtit kanë vendosur të blejnë 500 gr heroinës të cilën pastaj e ka sjell V H nga banesa e Ivica Guberac në Rr. 15 Maj në Koper dhe k[t] narkotik pastaj bashkë me të pandehurin Sh iu ka dorëzuar agjentëve të fshehtë rreth 17:45 h, të paketuar në dy pako, një prej 499,03 gr dhe tjetri nga 100,88 gr si kompensim për sasinë e munguar nga dërgesa paraprake e dt. 11. Maj 2016, e në sasi të përgjithshme prej gjithsej 599,91 gr, me çmimin prej 11.000 € ;
6. Gjatë muajit shtator 2016 e ka organizuar transportimin e drogës – kokainës në sasi prej të paktën 2.444 gr nga Spanja deri në Izolla të Sllovenisë, ashtu që në Spanjë e ka dërguar B I i cili nga persona të pidentifikuar e ka pranuar veturën e markës BMW X6, me kokainën të fshehur në të dhe është nisur në drejtim të Sllovenisë, por me dt. 01.10.2016

në afërsi të Millanos ka pas defekt, me ç'rast i pandehuri Sh, me qëllimin e transportimit të sigurt dhe të shpejtë të kokainës, e ka siguruar veturën rezervë, pronë e motrës së tij, dhe me atë veturë e ka dërguar B 1 në Milano, ku pastaj e kanë rregulluar veturën BMW dhe dy të lartcekurit me dy vetura së bashku kanë vazhduar rrugën drejt Sllovenisë, duke arritur që brenda kohës së planifikuar ta sjellin kokainën të cilën i pandehuri ka pasur për qëllim ta shes;

7. Me dt. 4. Tetor 2016 i pandehuri Sh H dy agjentëve të fshehtë të policisë për 100.000 € ua ka shitur 2.444 gr kokainë, të siguruar si në dispozitivin paraprak, nën nr. 6, të cilën iu ka dorëzuar në atë mënyrë që iu ka dhënë veturën e tij BMW X6, ndërsa vet e ka marrë veturën e tyre dhe është larguar për tu takuar me E Sh i cili me veturën Porsche, tip Cayenne, me targa nr. KP HM-675 nga Kopër ia ka sjell kokainën në Izolla rreth orës 12:20 minuta dhe ia ka dorëzuar të pandehurit Sh i cili pastaj e ka fshehur nën karrigen e përparme të bashkudhëtarit dhe atë veturë rreth 12:25 minuta, në parkingun e ish kantierit të anieve në Izola përsëri iu ka dorëzuar agjentëve të fshehtë;
8. Në depo të shoqërisë tregtare Kobra plus sh.p.k., në rrugën ... nr. 13 në Izola, për të cilën i pandehuri Sh H është i regjistruar si përfaqësuesi ligjor dhe i vetmi i punësuar, me qëllim të shitjes ka poseduar të fshehur 226,86 gr të drogës së kokainës, me PVC qese, ngjitës, dorëza dhe dy peshore digjitale të dedikuara për paketimin e narkotikëve, ndërsa në banesën e tij në rrugën Drevored 1 Maja në Izolla, e ka poseduar edhe 761,73 gr të drogës së heroinës, të cilët janë gjetur me rastin e bastisjes nga ana e policisë me dt. 04.10.2016 ;
9. Me anëtarët të tjerë të grupit të njëjtë kriminal, me qëllim të shitjes, në hapësirat e podrumit të banesës të cilën e ka përdor Ivica Guberac, në rrugën 15. Maji nr. 19/d në Koper, me qëllim të shitjes kanë mbajtur të fshehur 540,28 gr të drogës së heroinës dhe 26,86 gr të kokainës, e cila është gjetur me rastin e bastisjes nga ana e policisë me dt. 04.10.2016;
 - Me këtë, me persona të cekur më lart, të dënuar në Slloveni, e ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 273 par. 1 dhe 2 lidhur me nenin 281 par. 1 nënpar. 1.1 të KPRK të kryer në vazhdimësi, lidhur me nenin 81 të KPRK;

II. Si anëtar i grupit kriminal, me të gjykuarit V H, M Z, U R, M D, G D dhe disa anëtarë të tjerë të paidentifikuar, është marrë me kontrabandim të migrantëve ashtu që brenda periudhës kohore nga dt. 26 Korrik 2016 kur nga Kroacia në Slloveni ka kontrabanduar 3 shtetas të Kosovës - L Q, A B dhe L M, 2 shtetas të Sirisë Sinan Sexo dhe Nezir Sexo dhe 2 shtetas të Turqisë Ferman Sercan dhe Ilyas Atalay, të cilët policia e qytetit Ilirska Bistrica i ka ndaluar në fshatin Zemonska Vaga e deri më dt. 20. Shtator 2016, kur në Slloveni nga Kroacia e ka kontrabanduar shtetasin e Republikës së Shqipërisë, Antonio Kecin, i pandehuri Sh H me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë financiare, iu ka mundësuar kalimin e kufijve shtetërore dhe hyrjen e paligjshme së paku 8 grupeve të migrantëve nga shtetet e ndryshme të cilët nuk i kane plotësuar kushtet për hyrje në territorin e Republikës së Sllovenisë dhe shteteve të tjera të zonës së Shengenit, në atë mënyrë që me anëtarët të tjerë të grupit të tij kriminal migrantët i ka transportuar deri në Kroaci, nga andej nëpër pyll i kanë futur në Slloveni jashtë pikëkalimeve kufitare, në vijën Seçovlje - Dragonja, ashtu që i pandehuri Sh H i ka koordinuar veprimet e anëtarëve të grupit, e ka kryer mbikëqyrjen mbi kalimet kufitare dhe rrugët, pjesërisht edhe e ka kryer edhe transportimin, ndërsa migrantët pas hyrjes në Slloveni rrugën e kanë vazhduar me veturat private apo me taksi të angazhuar nga ana e grupit kriminal deri te destinacione të dëshiruara;

- Kontrabandimi me migrant nga neni 170 par 1 lidhur me par. 6 të KPRK në vazhdimsi, lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Andaj gjykata bazuar në nenet e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,42,43,45,46,73,74,75,80 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPRK-së, e gjykon:

DËNIM ME BURGIM DHE ME GJOBË

1. Të pandehurin Sh H për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 281 par.1 nën par.1.1 dhe 1.9 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe 20,000.00 € (njëzet mijë euro) gjobe,

2. Për veprën penale Kontrabandim me migrant nga neni 170 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së në vazhdimësi lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dënim me burgim prej 4 (katër) vite dhe 20,000.00 € (njëzet mijë euro).

Konform nenit 80 par.1 pika 2.5 të KPRK-së ndaj te pandehurit gjykata shqipton **dënim unik me burgim dhe gjobë:**

- Të pandehurit gjykata i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje **prej 5 (pesë) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej 40,000.00 euro (katër dhjetë mijë euro)** të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në 4 (katër) këste, këstin e parë ta paguaj në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në shumën prej 10,000.00 euro (dhjetë mijë euro), dhe çdo muaj vijues ta paguaj shumën e njëjtë, deri në përmbushjen e të gjithë shumë.

Bazuar në nenin 83 par.1 të KPRK-së të pandehurit i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim dhe nga data 19.08.2021.

Bazuar në dispozitën e nenit 266/1 nën par. 1.1 të KPPRK-së të pandehurit i vazhdohet paraburgimi deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

Obligohet i pandehuri të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën në lartësi prej 400 €.

Obligohet i pandehuri që në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit t'i paguajë shumën prej nga 100 euro të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë PPS.nr.87/2021 me dt.11.03.2021, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin Sh H për shkak të veprave penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 281 par 1 nën par 1.1 të KPRK-së të kryer në

vazhdimësi nga neni 81 të KPRK-së dhe veprën penale Kontrabandimi me migrant nga neni 170 par 1 lidhur me par.6 të KPRK-së në vazhdimësi lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Gjykata me datë 11.10.2022 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penalo juridike, në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit Merita Bina Rugova, i pandehuri Sh H me mbrojtësin av.Sylë Hoxha, në të cilin shqyrtim të pandehurit nga prokurori i shtetit i është lexuar aktakuza PPS.nr.87/2021 e dt.11.03.2023, ndërsa kryetari i trupit gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. I pandehuri në këtë shqyrtim është deklaruar i pafajshëm.

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve. Prokurori i shtetit dhe palët tjera në procedurë, kanë përmbledhur provat që mbështesin rastin dhe kërkesat e tyre.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 17.03.2023 në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Merita Bina Rugova, i pandehuri Sh H me mbrojtësit av.Sylë Hoxha dhe av.Haxhi Millaku sipas autorizimit dhe ky i fundit ka kërkuar nga gjykata që ti jepet kohë shtesë për ti parashtruar kërkesë prokurorisë për negocimin e pranimin të fajësisë e cila kërkesë i është aprovuar nga trupi gjykues.

Gjykata përsëri ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 18.04.2023 në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Merita Bina Rugova, i pandehuri Sh H me mbrojtësit av.Sylë Hoxha dhe av.Haxhi Millaku sipas autorizimit në të cilin shqyrtim përsëri mbrojtësit kanë kërkuar afat shtesë nga gjykata për të shikuar edhe njëherë mundësinë e negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me prokurorin e shtetit, e cila kërkesë përsëri i është aprovuar nga trupi gjykues.

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me seancën e datës 04.05.2023 në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Merita Bina Rugova, i pandehuri Sh H me mbrojtësit av.Sylë Hoxha dhe av.Haxhi Millaku sipas autorizimit, në të cilin shqyrtim palët në procedure e kanë njoftuar gjykatën se kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në formë të shkruar, ku deklarimet e palëve lidhur me marrëveshjen në fjalë janë të dhëna në shqyrtimin e datës 04.05.2023.

Trupi gjykues ka marr aktvendim me të cilën ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë pasi që ka konsideruar se janë plotësuar kushtet nga neni 230 par.17 të KPPRK-së pasi që i

pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është pranuar vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tij dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale dhe deklaratat e dëshmitarëve të rastit konkret, nuk ekzistojnë rrethana nga neni 248/1 të KPRK-së, andaj gjykata ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe ka urdhëruar që marrëveshja për pranimin e fajësisë të vendoset në shkresat e lëndës.

Pas aprovimit të marrëveshjes së fajësisë nga trupi gjykues, palët në procedurë janë deklaruar si në vijim:

Prokurori i shtetit ka theksuar se sa i përket dënimit nuk ka çfarë të shtoj dhe mbetet pranë propozimit për marrëveshje.

Mbrojtësi av.Haxhi Millaku mes tjerash ka deklaruar se pajtohet me dënimet e propozuara gjë për të cilat edhe ishte arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së pra rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, ku si rrethanë lehtësuese për të pandehurin mori marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur në mes të pandehurit, mbrojtjes, prokurorit të shtetit dhe kryeprokurorit të shtetit, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të tij, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti.

Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi dhe dënim me gjobë si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi (të propozuar edhe me marrëveshjen për pranimin e fajësisë) duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar mund të arrihet qëllimi i dënimit bazuar në nenin 41 i KPRK-së; të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 449 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të ligjit nr.05/L-036

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr.11/22 datë 18.05.2023

Sekretarja juridike:
Shqipe Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate, vetëm mbi baza tjera dhe jo mbi bazën e vendimit mbi dënimin, ngase i pandehuri ka hequr dorë nga kjo e drejtë.